



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREKTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE
ENERGJISË**

Nr 5399/prot.

Tiranë, më 16.3.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.577/1, datë 20.03.2012.

**SHOQËRISË “VASILI” SHPK
Mollaj, Bellovodë, Korçë**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë**

Shoqëria “Vasili” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.577/1, datë 20.03.2012, për mineralin gur gëlqeror, në objektin “Shkëmbi i Mjaltit”, Bellovodë, në Qarkun Korçë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së, me shkresën nr.5819, datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5399, datë 01.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.577/1, datë 20.03.2012, për mineralin gur gëlqeror, në objektin “Shkëmbi i Mjaltit”, Bellovodë, në Qarkun Korçë, për arsye se është ndërprerë puna, duke mos respektuar kërkesat e ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Leja nr.577/1, datë 20.03.2012, është dhënë në përputhje me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994, “Minerar të Shqipërisë”, të ndryshuar, që është shfuqizuar me ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3 të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në germën “c”, të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.577/1, datë 20.03.2012, për mineralin gur gëlqeror, në objektin “Shkëmbi i Mjaltit”, Bellovodë, në Qarkun Korçë, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.577/1 datë 20.03.2012, për mineralin gur gëlqeror, në objektin “Shkëmbi i Mjaltit”, Bellovodë, në Qarkun Korçë.

Në zbatim të nenit 49, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

